



ODA EKONOMIKE | KOSOVA CHAMBER
E KOSOVËS | OF COMMERCE

HAPJA E RRUGËS PËR BIZNES MË TË MIRË NË KOSOVË

CILAT JANË PENGESAT PËR RRIJTJEN E BIZNESIT NË KOSOVË?

BOTIMI 4



Prishtinë, 2018

HAPJA E RRUGËS PËR BIZNES MË TË MIRË NË KOSOVË

Cilat janë pengesat për rritjen e biznesit në Kosovë?

Botimi 4



PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	7
1. METODOLOGJIA	9
2. HYRJE DHE JUSTIFIKIM / ARSYETIM.....	10
3. PENGESAT JASHTË KOMPANISË	12
3.1 DHJETË PENGESAT KRYESORE PËR VEPRIMTARI BIZNESORE NË KOSOVË	12
3.1.2 PËRMBLEDHJE E PENGESAVE PËR BIZNESET: MJEDISI EKONOMIK	16
3.1.3 PËRMBLEDHJE E PENGESAVE PËR KUSHTET ADMINISTRATIVE DHE RREGULLATORE	18
3.1.4 PËRMBLEDHJA E PENGESAVE TË INFRASTRUKTURËS DHE KUSHTEVE TË PËRGJITHSHME	21
3.2 PENGESAT SIPAS SEKTORIT	23
3.3 PENGESAT SIPAS MADHËSISË SË KOMPANISË	25
3.4 PENGESAT SIPAS RAJONEVE	27
4. PENGESAT E BRENDSHME TË KOMPANIVE	30
4.1 FAKTORËT E BRENDSHËM SIPAS SEKTOREVE	32
5. TENDENCAT E KOMPANIVE	33
5.1 PRITJET E BIZNESEVE PËR ZHVILLIMIN E INVESTIMEVE NË VITIN 2018	41
5.2 FUQIA PUNËTORE	45
6. BARRIERAT E PËRGJITHSHME DHE SFIDAT.....	55
7. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....	61



Të nderuar miq dhe kolegë,

Pas studimit tremujorë mbi indikatorin e klimës së biznesit, Oda Ekonomike e Kosovës bëri një studim të “Fytave të ngushta-Bottleneck” mbi faktorët që pengojnë rritjen ekonomike në Kosovë.

Ky studim është i pari i këtij lloji në Kosovë. Jo vetëm që dokumenton faktorët jashtë kompanisë, por gjithashtu hedh dritë mbi faktorët brenda kompanisë, faktorë këta të cilët

pengojnë rritjen. Ky studim, jep informacion të vlefshëm në lidhje me barrierat e biznesit siç tregohet nga sektori i biznesit, për zhvillimin aktual dhe të ardhshëm.

Oda Ekonomike e Kosovës përmes këtij studimi ka për qëllim të ndikojë në debatin dhe masat për nxitjen e rritjes së kompanive në Kosovë dhe krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për biznes. Ky raport është i katërti i publikuar nga Oda Ekonomike e Kosovës që nga viti 2014.

Oda Ekonomike e Kosovës, përmes raporteve të tilla synon të mbajë të informuar komunitetin e biznesit Kosovar, po aq sa të llojë dhe të ngre zërin për interesat e tyre tek institucionet qeveritare, me të vetmin qëllim, përmirësimin e ambientit të të bërit biznes në Kosovë.

Komuniteti i biznesit në Kosovë luan një rol të rëndësishëm në krijimin e këtyre vlerave të brendshme dhe vendosjes së tyre në tregun rajonal dhe ndërkombëtarë. Rritja e sektorit privat në Kosovë do të ndikojë në përmirësimin e mirëqenies sociale dhe ekonomike në Kosovë. Gjithashtu do të kontribuojnë në përmirësimin e imazhit të vendit tonë dhe për të tërhequr investitorë të huaj përmes formave të ndryshme të partneritetit.

Ky studim së pari do t`u shpërndahet të gjitha kompanive që morën pjesë në studim, të gjitha institucionet qeveritare, organizatat e bizneseve, zyrat diplomatike, organizatat donatore dhe të gjithë akterët ku drejtpërdrejt apo tërthorazi ndikojnë dhe kontribuojnë në promovimin e aktiviteteve ekonomike të Kosovës.



Sinqerisht i juaji,

Safet Gërxhaliu
Kryetar



PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) që nga fillim-viti 2013, në baza të rregullta tremujore publikon studimin mbi klimën e biznesit dhe tendencat ekonomike në vend. Studimi në fjalë ofron informata shumë të dobishme për vendimmarrësit në nivel qeveritar dhe poashtu orientim të ndërmarrësve në kuadër të politikave të brendshme të kompanive. Megjithatë, ende nuk ka identifikuar faktorët themelorë të cilët tregojnë perceptimin mbi klimën e biznesit nga ana e kompanive.

Prandaj, Oda Ekonomike e Kosovës për të katërtin vit me radhë është duke e bërë edhe një studim kërkimorë për të identifikuar pengesat më të mëdha të cilat janë duke penguar funksionimin normal të kompanive. Këto pengesa janë të natyrës së jashtme dhe brendshme. Pengesat e jashtme mund të jenë si në vijim:

- Mjedisi/ ambienti ekonomik,
- Kushtet administrative dhe rregullative, dhe
- Aspekte të natyrës infrastrukturore.

Pengesat e brendshme janë të lidhura me çështje menaxheriale dhe operacionale.

Komuniteti i biznesit kosovar gjatë vitit 2017 ka raportuar si barrierën më të madhe *“konkurrencën jo lojale nga ekonomia e hirtë” (61%), pasuar nga “kostoja dhe besueshmëria në energjinë elektrike” (51%), “kamatat e larta dhe kostot tjera për transaksionet bankare” (38%), “mungesa e parasë së gatshme” duke nënkuptuar vonesat në pagesa nga ana e konsumatorëve (32.5%) dhe “mungesa e fuqisë punëtore të shkathtë” (31.6%).*

Dimensioni i barrierave administrative nxjerr në pah vështirësitë që hasin kompanitë kosovare në të dëshmuarit e standardeve ndërkombëtare si rezultat i kostove të larta që ato kanë (21.3%), pasuar nga mungesa e ligjeve adekuate të fushës së ekonomisë (19.2%) që për katër vite me radhë vihet në dukje nga komuniteti i biznesit, për të përmbyllur këto barrierë me rregulloret, procedurat e shumta dhe burokratike nga ana e Doganave të Kosovës (15.8%).

Barrierat infrastrukturore nga ana tjetër kanë vendin kryesor në mesin e top barrierave, me theks të veçantë kostoja dhe besueshmëria e energjisë elektrike (51.1%). Jo-qëndrueshmëria politike (37.8%) poashtu zë vend në mesin e barrierave kryesore në këtë kategori, e cila si e



tillë është dëshmuar edhe në bazë të raporteve të tjera të publikuara nga OEK-u, siç është “Indeksi i Klimës së Biznesit”, që në periudhat kur vendi jonë ka jo stabilitet politik, besimi i bizneseve bie. Nga ana tjetër korrupsioni (28.5%), në vitin 2017 u cilësua si njëra nga barrierat kryesore për bizneset e Kosovës.

Studimi përfundon me një numër të konkluzioneve dhe rekomandimeve. Këto mund të adresojnë pengesat më të theksuara të jashtme dhe të brendshme, duke krijuar një mjedis të përshtatshëm në të cilin kompanitë mund të veprojnë më mirë dhe ndihmohen për t'i kapërcyer, ose të përballen me pengesa të jashtme dhe të brendshme.

1. METODOLOGJIA

Pengesat e rritjes për bizneset në Kosovë janë analizuar në këtë raport me ndihmën e një ankete me biznese të realizuar nga Oda Ekonomike e Kosovës. Anketa përdor një pyetësor, i cili në veçanti u zhvillua dhe modifikua për gjendjen ekonomike në vend.

Pyetësi me pyetje specifike është zhvilluar nga stafi i OEK-ut, respektivisht nga Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Politikave. Pyetësi përbëhet nga katër pjesë: Pjesa e parë shqyrton disa karakteristika të kompanisë. Pjesa e dytë fokusohet në vlerësimet e situatës ekonomike të kompanisë në lidhje me shitjet dhe investimet. Pjesa e tretë përmban pyetje lidhur me pengesat për veprimtarinë e kompanive. Pengesat janë klasifikuar në tri kategori të pengesave të jashtme: mjedisi ekonomik, kushtet administrative dhe rregullatore, si dhe infrastruktura dhe kushtet e përgjithshme. Përveç faktorëve të jashtëm, janë përfshirë gjithashtu pyetje për pengesat e brendshme.

Në fund të pyetësit ne kemi shtuar një seksion të veçantë në lidhje me barrierat e biznesit në fusha më të gjera.

Karakteri i anketës është edhe cilësore edhe sasiore. Pra, të anketuarit janë pyetur për të dhënë përgjigje në bazë kualitative verbale, po ashtu u është kërkuar të japin rekomandimet e tyre në fusha të caktuara. Opsionet për përgjigje janë për shembull: asnjë pengesë / pengesë mesatare/ pengesë e madhe ose nuk zbatohet.

Madhësia dhe struktura e mostrës plotëson kriteret statistikore për të fituar rezultate përfaqësuese. Të dhënat janë mbledhur nga intervistat personale. Stafi i OEK-ut vizitoi bizneset në mes të 8 dhe 26 janar 2018. Bizneset e vizituara janë përzgjedhur nga baza e të dhënave e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK).

Edhe pse hulumtimi është kryer në ditët e para të vitit 2018, ato pasqyrojnë situatën e bizneseve për vitin 2017.



2. HYRJE DHE JUSTIFIKIM / ARSYETIM

Një sektorë privat aktiv është vendimtar për suksesin e një ekonomie. Bizneset punësojnë njerëz dhe bëjnë investime. Biznesi në ngritje i kontribon ekonomisë në masë të madhe. Andaj është e rëndësishme të kuptohet se cilët faktorë pengojnë bizneset në veprimtarinë e tyre. Në një ekonomi në tranzicion mjedisi ekonomik për biznese ndryshon shpejt. Të kuptuarit e faktorëve të cilët janë duke penguar veprimtarinë biznesore në një moment kohor është me rëndësi, dhe kjo është ajo çfarë Oda Ekonomike e Kosovës është duke bërë tani me studimin mbi pengesat e të bërit biznes. Poashtu, monitorimi/ mbikqyrja e mjedisit/ ambientit për një kohë, së paku në ritëm vjetor, është me rëndësi. Me anë të krahasimeve kohore, mund të analizohet ndryshimi i mjedisit ekonomik dhe në këtë mënyrë mund të zbulohet çfarëdo lloj përmirësimi apo përkeqësimi. Prandaj, realizimi i këtij studimi në baza vjetore, çfarë edhe synohet-është studimi i katërt i këtij lloji- i cili do të jetë edhe më i miri.

Ky studim hedhë dritë mbi problemet, të cilat janë perceptuar nga bizneset. Ndryshe nga disa studime ad-hoc të ndërlidhura me këtë temë, jo vetëm “fytet e ngushta” në ambientet jashtë kompanive (p.sh. infrastrukturë, standarde ndërkombëtare në tregti dhe prodhim, taksa, çasje në financa etj.), por poashtu probleme brenda kompanisë (si kualiteti i prodhimeve/ shërbimeve, mungesa e kanaleve të shpërndarjes, mungesa e investimeve në staf brenda kompanive, mungesa e një plan biznesi adekuat, etj.) janë të monitoruara.

Të dhënat janë të ndara sipas sektorit në të cilin kompania është duke operuar si dhe madhësisë së kompanisë. Raporti gjithashtu përfshin aspektin rajonal/komunat, me qëllim që të identifikohen pengesat në bazë të ndikimeve rajonale.

OEK ofron një raport të progresit të pengesave të jashtme dhe të brendshme me të cilat kompanitë ballafaqohen në të bërit biznes. Ky informacion do t’ju ndihmojë të gjithë agjentëve ekonomik – politikave ekonomike si dhe vetë menaxhmentit të kompanive- që të implementojnë masa për të përmirësuar mjedisin biznesor.

Rezultatet e paraqitura në këtë raport janë bazuar në një studim të gjërë biznesor. Oda Ekonomike e Kosovës ka zhvilluar pyetësin dhe mëpastaj e ka implementuar studimin. Studimi është bërë përmes intervistave personale në periudhën kohore nga 8 deri me 26 Janar 2018. Oda Ekonomike e Kosovës për qëllim të studimit ka intervistuar 461 kompani.

Studimi reflekton situatën e kompanive gjatë vitit 2017. Raporti është përgatitur nga znj. Olivera Ceni Bardiqi dhe znj. Muela Ibrahimimi - Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Politikave në Odën Ekonomike të Kosovës.

Raporti fillon me pengesat e jashtme, ashtu si janë parë nga kompanitë, të pasuara nga faktorët e brendshëm që i kërcënohen biznesit. Tema e dytë më kryesore merret me investimin e planifikuar dhe pritjet e shitjeve për vitin 2018.

Rezultatet janë analizuar në bazë të sektorit dhe madhësisë. Të madhësive, mikro prej <9 punëtorë, të vogla nga 10 deri në 49 punëtorë, të mesme nga 50 deri në 249 punëtorë, dhe të mëdha mbi 250 punëtorë.




3. PENGESAT JASHTË KOMPANISË

Oda Ekonomike e Kosovës, që nga viti 2014 në baza të rregullta publikon raportin vjetor mbi barrierat e të bërit biznes në Kosovë, duke identifikuar top 10 barrierat, pengesat e natyrës ekonomike, administrative, infrastrukturore dhe problemet e brendshme të sektorëve specifik.

Ndonëse Kosova ka shënuar progres sipas vlerësimeve të Bankës Botërore, respektivisht raportit “Doing Business” që e rankon vendin tonë në pozitën 40, sfidat mbeten ende të mëdha. Konform edhe të të gjeturave nga raportet e rregullta të publikuara nga Oda Ekonomike e Kosovës mbi konfidencën e bizneseve, ekonomia e Kosovës ka shënuar progres gjatë vitit 2017. Megjithëse, pati ngecje në disa prej segmenteve kyqe. Bizneset e Kosovës edhe në vitin 2017 vazhduan të kenë probleme me furnizim të rregullt me energji elektrike dhe ekonominë informale.

Hulumtimi ka radhitur dhjetë pengesa kryesore, të paraqitura si në vijim:

3.1 Dhjetë pengesat kryesore për veprimtari biznesore në Kosovë



Për dallim prej dy viteve të fundit, bizneset kosovare në këtë vit raportuan problemin e ndikimit të konkurrencës jolojale dhe ekonomisë informale me përqindjen më të madhe.

Kosova përballlet me një ekonomi informale në shkallë të lartë. Institucionet e vendit, respektivisht Ministria e Financave e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë kanë ndërmarrë masa për zbutjen e shkallës së informalitetit në mes të bizneseve. Megjithatë, iniciativat dhe programet vetdijësuese nuk rezultuan edhe shumë të suksesshme. Qeveria e Republikës së Kosovës pati hartuar një plan veprimi 2014-2018. Ky plan përbëhej nga gjithsejtë 51 aktivitete individuale, të cilat duhet të kryhen për arritjen e objektivave strategjike të Strategjisë Kombëtare 2014-2018. Vetëm në fund të 2018-ës do të mund të komentojmë rezultatet dhe të arriturat e kësaj strategjie kombëtare.

Sipas Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (2002), ekonomia joformale e hirt përbëhet nga aktivitetet që janë produktive dhe ligjore, por me qëllim të fshehjes nga autoritetet publike për të shmangur pagesën e tatimeve dhe/ose kontributeve të sigurimeve shoqërore ose të jenë në pajtueshmëri me rregulloret. Të hyrat nga ekonomia joformale e hirtë duhet të taten¹. Sipas komunitetit të biznesit kosovar, ekonomia informale është përshkallëzuar për shkak të shumë faktorëve, por ndër më kryesorët raportohet të jetë ngecja në fuqizim të rendit dhe ligjit në vendin tonë, pasuar nga mos zhvillimi ekonomik i mirëfilltë. Bazuar edhe në praktikat e vendeve të tjera që janë ose kaluan tranzicionin, tranzicioni i shpejtë drejtë ekonomisë së tregut ka luajtur rolin kryesor në rritjen e shkallës së informalitetit. Tjetër, shkalla e lartë e papunësisë në vend (30.6%) dhe poashtu shkalla e lartë e varfërisë (17.6%, 2015) kanë ndikuar që fuqia punëtore e Kosovës të gjejë zgjidhjen e vetme punësimin në tregun informal, si një indikatorë tjetër që e rrit përqindjen e ekonomisë informale në vend.

Efektet negative të ekonomisë informale në vend ndjehen në të gjitha dimensionet, bizneset nga njëra anë zvogëlojnë mundësitë për të përfituar nga programe të mbështetjes dhe financimit, shteti nga ana tjetër humbet nga mos mbledhja e taksave dhe tatimeve, ndërsa fuqia punëtore pëson humbjen më të madhe duke mos u bërë pjesë e kontribut-dhënësve qoftë në sistemin tatimor qoftë atë pensional.

¹ Matja e Ekonomisë së pa vëzhguar – A Doracaku', OBZHE, 2002.

Si barrierë e dytë më e raportuar është besueshmëria dhe kostoja e energjisë elektrike. Komuniteti i biznesit kosovar për të katërtin vit me radhë ngreh zërin sa i takon problemve që energjia elektrike u shkakton atyre gjatë ciklit të prodhimit. Ndërprerjet e shpeshta dhe të paparalajmëruara të energjisë elektrike shkaktojnë humbje të mëdha për bizneset, veçanërisht ato prodhuese. Si alternativë për gjendjen e rëndë energjetike në vend, komuniteti i biznesit kosovar ka parë investimet në gjeneratorë dhe panele diellore. Megjithëse furnizimi me energji elektrike nuk është i kënaqshëm dhe ka të metat e saj, nga ana tjetër kostoja e energjisë sipas bizneseve paraqet koston më të papërballueshme dhe ndikon në masë të madhe në profitabilitetin e tyre. Humbjet e kompanive tona nga ndërprerjet e paparalajmëruara të energjisë shkaktojnë humbje në mes € 1,000 dhe € 5,000 për bizneset jo prodhuese, ndërsa për sektorin prodhues dëmi që u shkaktohet sillet mbi € 10,000.


Qeveria e Kosovës në dhjetor të 2017-ës, pati nënshkruar marrëveshjen komerciale me kompaninë amerikane Contour Global, për ndërtimin e Termocentralit "Kosova e Re". Sipas kësaj marrëveshjeje, ndërtimi i termocentralit do të ketë një bllok prej 500 megavatëve dhe do të kushtojë 1.3 miliard euro. Sektori privat ka pritjet e veta rreth kësaj kontrate dhe furnizimit të rregullt dhe stabil me energji elektrike, çka do të ndikonte në rritje të produktivitetit dhe minimizim të humbjeve të shkaktuara nga ky fenomen. Megjithëse, mbetet ende për t'i parë rezultatet e kësaj marrëveshjeje, komuniteti i biznesit kosovar paraqitet optimist. Termocentrali "Kosova e Re" parashikohet të vihet në funksion në vitin 2023, ndërsa deri në funksionalizimin e saj bizneseve u mbetet të llogarisin në gjeneratorë dhe alternativa të tjera.

Siç edhe kemi raportuar në vitin e kaluar, kur bizneset patën theksuar në përqindje më të vogël barrierën me furnizimin dhe koston e energjisë elektrike, OEK-u tërhoqi vërejtjen që problemi i energjisë elektrike në fakt nuk ishte bërë më i vogël (pasi që një rënie e konsiderueshme u prezantua në raportin e vitit 2015), por u trajtua si një situatë ku bizneset ia dolën të organizojnë më mirë aktivitetin tyre biznesor në mënyrë që më lehtë të përballen me problemin në fjalë. Megjithatë, raportimet e fundit nga bizneset edhe një herë kanë rishfaqur qështjen që kostoja e energjisë vazhdon të jetë ndër pengesat më të madha.

Në dimensionin rajonal, bizneset e komunës së Ferizajt paraqitet të kenë problemin më të madh me energjinë elektrike (79%), pasuar nga rajoni i Prishtinës (52.02%) dhe Prizrenit (47%). Ndër problemet e tjera të përmendura nga bizneset janë: kamatat e larta dhe kostot

tjera për transaksione bankare (38%), vonesat në pagesa nga ana e konsumatorëve (32.5%), mungesa e fuqisë punëtore me shkathtësi të veçanta (32%), korrupsioni (28%) duke e përmbyllur top dhjetëshën e barrierave me mos zhvillimin e biznes planit adekuat (24%).

3.1.1 Top dhjetë pengesat (dallimet në mes të vitit 2014, 2015, 2016 dhe 2017)



Sipas raportimit të bizneseve duket që cilësia e shërbimeve/produkteve është rritur, krahasuar me vitin 2016 (31.8%), në këtë vit vetëm 19.6% e bizneseve të anketuara thanë që kualiteti i produkteve nuk është konkurrues. Poashtu, sistemi i taksave nuk paraqitet të jetë problem në masë të madhe, krahasuar me vitin paraprak gjendja paraqitet të jetë më e mirë



për 17.5% të bizneseve. Pako e re fiskale e miratuar kohë më parë nga qeveria është pritur mirë nga bizneset.

3.1.2 Përmbledhje e pengesave për bizneset: Mjedisi ekonomik

Pas konkurrencës jolojale dhe ekonomisë së hirtë, në kategorinë e barrierave të mjedisit ekonomik paraqiten problemet e financimit nga bankat, respektivisht normat e larta të kamatave dhe kostot për transaksionet bankare (38%). Krahasuar me vitin 2016 (41%), në këtë vit kemi një përmirësim të lehtë të gjendjes. Normat e larta të interesit dhe kostot e transaksioneve bankare, nga ana e bankave dhe institucioneve mikrofinanciare arsyetohen për shkak të shkallës së lartë të rrezikut që ato paraqesin, kryesisht në kthim të kredisë, megjithatë bazuar në të dhënat e anketës së realizuar në Gusht të vitit 2017 nga OEK, mbi vlerësimin e nevojave të ndërmarrjeve mikro dhe të vogla në Kosovë, ku janë anketuar 9 banka komerciale dhe 14 institucione mikrofinanciare, shkalla e kredive joperformuese sillet vetëm në mes 1% deri në 5%. Problem i theksuar i bizneseve paraqiten të jenë vizitat e shpeshta të zyrtarëve të bankës gjatë periudhës së kthimit të kredisë. Sipas të të njëjtit raport, 14.2% e vizitave në kompani bëhen katër e më shumë herë gjatë vitit.


Barrierat e ambientit ekonomik



Barriera e dytë më madhore në kuadër të ambientit ekonomik është vonesa në pagesa nga ana e konsumatorëve (32.5%), e cila duket të jetë problem në rritje në vitet e fundit. Kjo gjendje në parim duket të jetë si rezultat i mungesës së parasë së gatshme në nivel vendi, problem zingjiror që ndikohet nga mungesa e politikës udhëheqëse monetare të vendit tonë dhe rrjedhimisht qarkullimi i ultë i parasë në nivel vendi e shton nevojën për mjete financiare shtesë e cila në qoftë se do të arrihej do të rriste aktivitetin ekonomik në vend.

Edhe në këtë vit sektori i tregtisë me pakicë në rajonin e Prishtinës (32%) dhe Ferizajt (26%) raportuan mungesën e porosive në përqindje më të lartë krahasuar me sektorët e tjerë. Një problem të tillë e ka edhe sektori i prodhimit, megjithëse përqindja është më e vogël. Problemin më të madh me mungesën e porosive e kanë ndërmarrjet mikro, pasuar nga ndërmarrjet e vogla.

Barrierat e ambientit ekonomik sipas viteve





3.1.3 Përmbledhje e pengesave për kushtet administrative dhe rregullatore

Kjo kategori përmban një numër të konsiderueshëm të barrierave të cilat paraqiten të jenë pengesë e madhe në vitet e fundit. Ndërmarrësia kosovare ka pasur sfida të ndryshme që nga paslufta, fillimisht me ngritje të kapaciteteve teknike dhe infrastrukturore të cilat si proces zgjatën shumë dhe ende vërehet nevoja për avancimin e tyre. Sfidat e prodhuesve vendor janë veçanërisht të dukshme që pas pavarësimit të vendit. Eksportet e Kosovës nuk arrijnë të mbulojnë importin në më shumë se 13% të tyre, me çka pasqyrohet edhe zhvillimi ekonomik që Kosova ka arritur në vitet e fundit.


Marrëveshja CEFTA nuk duket t'i ketë sjellur shumë përfitime Kosovës, jo për shkak të ngecjeve substanciale të vendit, por më tepër si rezultat i pengesave në arritjen e cilësisë dhe aplikimin e standardeve ndërkombëtare për tregti. Problemi, duket të jetë më i madh tashmë pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, kur prodhuesit kosovar po përballen me tregun "agresiv europian".

21.3 përqind e bizneseve të anketuara në këtë studim deklaruan që problem kryesor kanë kostot e larta për të dëshmuar standardet ndërkombëtare dhe mungesën e stimujve nga ana e qeverisë së vendit për përkrahje në këtë aspekt.

Certifikimi, licencimi dhe standardizimi ende mbetin sfida për prodhuesin kosovar, me cka do t'u mundësohej atyre çasje më e lehtë në tregun europian dhe konkurrueshmëri më e denjë me prodhimet e tyre.

Licencat e eksport/importit mbeten ende në mesin e barrierave të cilat theksohen nga kompanitë tona (kryesisht prodhuese dhe tregtare me pakicë). Rreth 14 përqind e kompanive pjesëmarrëse në këtë studim kryesisht ndërmarrje mikro përmenden licencat si problem.

Kushtet administrative dhe rregullatore




Krahasuar me vitin 2016, ndërmarrjet e anketura në vitin 2017 raportuan se rregullat dhe procedurat doganore janë përmirësuar dhe kanë ndikim më të vogël në bizneset e tyre. Gjendja paraqitet dukshëm më e mirë krahasur me vitin 2015 sa i takon procedurave doganore. Megjithatë, përqindja e kompanive që paraqesin procedurat doganore si barrierë është ende e lartë, kryesisht në sektorët e tregtisë me pakicë dhe të prodhimit, pasur nga sektori i tregtisë me shumicë.

Nga ana tjetër 19.2 përqind e bizneseve kanë deklaruar që ligjet në fuqi nuk janë aspak favorizuese dhe nuk gjejnë zbatim në të bërit biznes në vendin tonë. Në këtë aspekt, megjithatë, krahasuar me vitin paraprak, gjendja është më e mirë. Kosova për shkak të proceseve ekonomike dhe politike, duke synuar të jetë në hap me praktikat dhe vlerat europiane shpeshherë ka adaptuar ligje të cilat nuk kanë arritur të gjejnë zbatim të suksesshëm në praktikë, veçanërisht ato ligje të fushës ekonomike ku involvohen direkt komuniteti i biznesit. Sektorët më të dëmtuar si rezultat i kornizës ligjore jo adekuate janë sektori i tregtisë me pakicë (34%) dhe ai i prodhimit (31%). Bizneset e rajonit të Ferizajt kanë deklaruar një përqindje më të lartë të ndikimit negativ që ligjet joadekuate kanë në aktivitetin e tyre biznesor (32%), pasur nga rajoni i Prishtinës (27%) dhe rajoni i Pejës (20%). Problemi është më i theksuar tek ndërmarrjet mikro (65%) dhe ato të vogla (24%).




Pengesat administrative dhe rregullative sipas viteve



3.1.4 Përmbledhja e pengesave të infrastrukturës dhe kushteve të përgjithshme

Sipas të të gjeturave, kategoria e pengesave infrastrukturore përmban pjesën më të madhe të top 10 barrierave. Përveç kostos (50.1%) dhe besueshmërisë (furnizimi i rregullt dhe stabil) (51.1%) së energjisë elektrike, barrierat më të theksuara janë jo-stabiliteti politik (37.8%) dhe korrupsioni (28.5%).

Jo-stabiliteti politik është dëshmuar të jetë faktor me ndikim negativ në aktivitetin biznesor të vendit. Bazuar edhe në të gjeturat e anketës së Konfidencës së Biznesit në Kosovë, në periodat kur vendi është në krizë politike ose institucionale, besimi i bizneseve bie dhe rritet pakënaqësia, duke ndikuar kështu në performancë më të dobët të bizneseve vendore. Kjo rrjedhimisht ka ndikuar edhe në imazhin e Kosovës dhe mundësitë për të promovuar vendin tonë si destinacion për investime të huaja, ku sipas të dhënave të Bankës Qëndrore të Republikës së Kosovës, investimet e huaja direkte në dy vitet e fundit kanë rënë konsiderueshëm.






Bizneset kosovare në shkallë të lartë kanë raportuar rritjen e krimit, vandalizmit dhe vjedhjes në vitet e fundit. Megjithëse, përqindja ka rënë, niveli mbetet ende shqetësues.

Barrierat e dimensionit infrastrukturor kanë mbetur pothuajse të njëjta në katër vitet e fundit, me gjithë ndryshimet e lehta që kanë pësuar ndër vite, qoftë në përmirësim ose në përkeqësim të gjendjes. Përveç energjisë elektrike, barrierat e tjera të këtij seksioni duket të kenë ndikim më të vogël në rrjedhën e biznesit. Kompanitë kosovare në vitin 2017 nuk kanë përmendur shumë problemin e furnizimit me ujë dhe aspektin e transportit.

Barrierat infrastrukturore dhe kushtet e përgjithshme sipas viteve



3.2 Pengesat sipas sektorit

Shikuar nga aspekti sektorial, barrierat pësojnë dallime të shumta. Sektori i tregtisë me pakicë dhe ai i prodhimit janë ndër sektorët që kanë raportuar pengesat më të mëdha, kryesisht të aspektit infrastrukturor dhe ekonomik. Sa i takon pengesës nga konkurrenca jolojale dhe ekonomisë së hirtë, dallimi mes sektorëve bëhet pothuajse i padukshëm. Përqindja e bizneseve që raportuan atë si barrierë kryesore sillet mes 50 dhe 62 përqind, varësisht prej pjesëmarrjes së sektorit.

Dallimet në mes të sektorëve vërehen në disa prej të gjeturave kryesore, respektivisht për sektorin e ndërtimit (36%), energjia elektrike nuk paraqet problem aq të madh siç është rasti i sektorit të prodhimit (59%).

Sektori i ndërtimit poashtu nuk duket të afektohet edhe aq shumë nga jo-stabiliteti politik në vend, krahasuar me të gjithë sektorët e tjerë të ekonomisë.

Megjithatë sektori i ndërtimit ka problem pothuajse kryesor, vonesën në pagesa nga ana e konsumatorëve, duke ndikuar kështu edhe në ulje të aktivitetit ekonomik të tyre.


Normat e larta të kamatave të aplikuara nga bankat komerciale të vendit, shfaqin sërish ngjajshmëritë në barriera sa i takon aspektit sektorial. Kryesisht sektori i tregtisë me shumicë (50%), prodhimit (40%) dhe ai i shërbimeve (28%) ballafaqohen me këtë problem. 37 përqind e kompanive të anketuara nga sektori i prodhimit vënë theksin tek mungesa e kuadrove të kualifikuara me shkathtësi të veçanta për të performuar punën në kompani, pasuar nga sektori i tregtisë me shumicë (32%), dhe sektori i tregtisë me pakicë (25%).

Duke konsideruar barrierat e raportuara, në mesin e së cilave rolin kyq luan sektori i prodhimit, i mbetet ende shumë punë Qeverisë së Kosovës në orientim të politikave në përkrahje të sektorit prodhues, veçanërisht në eliminim të barrierave që do të ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e aftësive konkurruese të kompanive kosovare dhe përmirësim të deficitit tregtar të Kosovës, përmes rritjes së eksportit.

Përkrahja e sektorit prodhues, veçanërisht në aspektin e arritjes së standardeve ndërkombëtare, lehtësira në marrjen e licencave për eksport dhe import, përmirësimi i ambientit ligjor, sundimi i rendit dhe ligjit, eliminimi i procedurave të panevojshme doganore mbesin rekomandimet kryesore të OEK-ut drejtuar Qeverisë së Kosovës në drejtim të përkrahjes së sektorit prodhues në vend.



Barrierat sipas sektorëve



3.3 Pengesat sipas madhësisë së kompanisë

Sipas madhësisë së firmës, firmat e vogla raportojnë numrin më të madh të barrierave në nivel vendi.

Barrierat infrastrukturore paraqiten të jenë më problematike për ndërmarrjet mikro në vend, duke vënë theksin e veçantë tek kostoja dhe besueshmëria e energjisë elektrike, jo-stabiliteti ekonomik, niveli i krimit (vjedhja, vandalizmi) dhe korrupsioni. Rreth 26 përqind e kompanive të vogla raportuan korrupsionin të jetë në mesin e barrierave që sfidojnë aktivitetin e tyre biznesor.

Barrierë tjetër, nën kategorinë e pengesave ekonomike janë normat e larta të interesit, kryesisht për ndërmarrjet mikro dhe ato të vogla. Megjithatë, problemi i kamatave mbetet ende dekurajues edhe për ndërmarrjet e mëdha në vendin tonë. 50 përqind e kompanive me numër të punëtorëve mbi 250, vënë theks në vështirësinë që kanë në këtë aspekt, duke aluduar tek kostoja dhe shpenzimet që ngërthen brenda vetes kjo formë e financimit për ndërmarrjet kosovare.


Ndërmarrjet mikro në Kosovë gjatë vitit 2017 janë përballur edhe me mungesë të porosive (25%). Problem të ngjashëm kanë edhe ndërmarrjet e mëdha, ku 50 përqind e tyre rankuan mungesën e porosive në mesin e top barrierave të të bërit biznes.

Nga ana tjetër rreth 35 përqind e kompanive të vogla të anketuara në këtë studim deklaruan që barrierë për ta ende mbeten vonesat në pagesa nga ana e konsumatorëve, kryesisht si rezultat i mungesës së parasë së gatshme në nivel vendi.

Afërsisht 21 përqind e ndërmarrjeve të mesme, theksuan koston e lartë për të dëshmuar standardet ndërkombëtare ndër barrierat kryesore, pasuar nga mungesa e ambientit të përshtatshëm ligjor (19%) dhe lejet e ndërtimit (19%).



Barrierat sipas madhësisë së kompanisë



3.4 Pengesat sipas rajoneve

Në nivel rajonal, për dallim prej vitit 2016, kur rajoni i Prishtinës paraqitej me shkallën më të lartë të barrierave, në këtë vit shtrirja është pothuajse e njëjtë, me përjashtim të kostos dhe besueshmërisë në energjinë elektrike (48%), konkurrencës jo lojale dhe ekonominë e hirtë (58%) dhe aspektin e normave të larta të kamatave (23%) ku rajoni i Prishtinës bën dukshëm diferencimin nga rajonet e tjera.

Komuniteti i biznesit në rajonin e Ferizajt (63%) përballlet me mungesën e fuqisë punëtore të shkathtë. Sektori i prodhimit i këtij rajoni, veçanërisht në industrinë e drurit vë theksin e veçantë në nevojat për trajnime, veçanërisht të rinjëve që hyjnë në tregun e punës përmes programeve të praktikës profesionale. Sipas këtyre kompanive, mungesa e një bashkëpunimi të ngushtë të katërkëndëshit komunitet i biznesit – qeveri – shkollë - përfaqësuesit e punëmarrësve, paraqet sfidë shtesë për ta. Në fakt kjo është e identifikuar edhe në Strategjinë Sektoriale të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale 2018-2022, "Përkundër faktit që në Manualin Operacional për Trajnim në Punë të vitit 2014, të hartuar nga MPMS, theksohet se Departamenti për Punë dhe Punësim i MPMS-së paguan sigurimin në punë për pjesëmarrësit e angazhuar në trajnim në punë/kompani, në praktikë ky obligim nuk është realizuar, por që në Plan të Veprimit parashihen të mbulohen, për një numër të trajnuarve". Në mungesë të një platforme të nivelit kombëtar, në këtë drejtim ka iniciativa të veçanta për rregullimin e kësaj çështje edhe pse në parim mendohet që është e rregulluar me ligj, prap se prap sigurimi i kandidatëve shumëherë mbetet çështje e hapur dhe mjaft problematike, veçanërisht sa i takon rrezikut që kompanitë marrin me rastin e pranimit të kandidatëve në praktikë pa sigurimin e jetës, me theks të veçantë në sektorët me rrezikshmëri të lartë. Në rast të një aksidenti eventual në vendin e punës pa sigurim, pasojat për ndërmarrjen janë jashtëzakonisht të papërbalueshme, që mund edhe të rezultojë në falimentim.


Mungesa e bashkëpunimit të pritur nga akterët e lartëcekur, rezulton me mos bashkërendimin e aktiviteteve për përmirësimin e cilësisë në fushën e arsimit profesional dhe zhvillimin e fuqisë punëtore. Në çfarëdo forme, gjerësisht njihet se cilësia e përgjithshme e nxënësve që diplomohen nga shkollat tona është e pamjaftueshme për t'u punësuar në ndërmarrje pa arsimim të mëtijmë në vendin e punës. Kjo e gjetur është e theksuar edhe në raportin e progresit për Kosovën në vitin e fundit.



Arsimi dhe aftësimi profesional është i pamundur pa përfshirjen e sektorit privat për të dhënë kontributin profesional, financiar dhe përmbajtësor të tematikës mësimore. Për fat të keq deri me tani, dhe përkrahja financiare nga donatorët është orientuar kryesisht në fuqizimin e sektorit publik (kryesisht shkollave) duke harruar përfshirjen e komunitetit të biznesit dhe përfaqësuesve të tyre. Praktikata e mira evropiane kanë dëshmuar që nga njëra anë është e domosdoshme fuqizimi i Odës Ekonomike të Kosovës si partner ligjor dhe strategjik në fushën e arsimit dhe aftësimit profesional si dhe përkrahja profesionale tek ekspertët në ndërmarrje, përkatësisht ngritjen e kapaciteteve apo instruktorëve. Këta ekspertë në ndërmarrje do të ishin urë lidhëse e bashkëpunimit në mes të kompanive dhe institucioneve arsimore në vend me qëllim që përmbajtja mësimore të jetë në hap me kërkesat e tregut. Në këtë kontekst OEK-u ka ndërmarrë hapa për të gjetur modalitetet e institucionalizimit të kësaj hallke të rëndësishme në procesin edukativo-arsimor. Përveç këtij aspekti, me qëllim mbështetjen e ndërmarrjeve tona kryesisht në ngritjen e kapaciteteve profesionale, Oda Ekonomike e Kosovës në bashkëpunim me Odën Zejtare të Dortmundit ofron programe trajnimi në fusha të ndryshme të cilat kryesisht konsiderohen deficitare në vendin tonë. Sipas studimit të realizuar nga OEK-u në vitin 2016, për vlerësim të nevojave për kuadro profesionale nëpër kompani, del që ndërmarrjet tona kanë nevojë kryesisht për profile teknike, si p.sh: saldues, agjent të shitjes, menaxher, etj, profile që mbulohen me programe trajnimi nga OEK-u. Mungesë të fuqisë punëtore të shkathtë ka edhe rajoni i Pejës (42%), megjithëse krahasuar me rajonin e Ferizajt përqindja është dukshëm më e vogël. Bizneset e rajonit të Ferizajt (61%) dhe ato të rajonit të Pejës (51%), kanë vënë theksin edhe në një problem tjetër që për rajonet e tjera duket të jetë më pak problematike, siç është mungesa e një biznes plani adekuat dhe të zhvilluar mirë. Kjo barrierë është ngritur si shqetësim që nga viti 2014 në raportet e OEK-ut, meqenëse problemi bëhej më i madh nga viti në vit. Përderisa në vitin 2014, rreth 17% të kompanive deklaruan që mungesa e një biznes plani adekuat paraqiste problem për kompaninë e tyre, në vitin 2015 kjo përqindje arriti 27%. Si rezultat i mungesës së një mekanizmi shtetëror për të ndihmuar bizneset në këtë drejtim, Oda Ekonomike e Kosovës në vitin 2017 krijoi platformën online për hartim të planeve të biznesit, me çka u mundësohej fillimisht anëtarëve të OEK-ut të zhvillojnë planin biznesor përmes udhëzuesve dhe manualit.²

²Oda Ekonomike e Kosovës ka krijuar platformën online për të gjitha bizneset që nuk kanë të zhvilluar një plan të biznesit për t'u lehtësuar atyre të bërit biznes, veçanërisht në çasje në financa, ku biznes plani luan rolin kryesor. Çasja në këtë platformë bëhet përmes: www.oek-biznesplan.org

Barrierat sipas rajoneve






4. PENGESAT E BRENDSHME TË KOMPANIVE

Në kapitullin tre do të diskutohen faktorët e brendshëm. Sipas të gjeturave, kompanitë kosovare kanë problem fitimin e ultë (26.2%), me çka sipas tyre po u vështirësohet në masë të madhe aftësia konkurruese dhe rritja e aktivitetit biznesor.

Barriera e dytë më e theksuar në kuadër të këtij seksioni është mungesa e një plani biznesi adekuat. Sipas kompanive të anketuara, sa i takon aspektit të financimit të biznesit nga bankat komerciale, institucionet mikrofinanciare ose donatorët e ndryshëm, në të shumtën e rasteve refuzimi është si rezultat i mos prezantimit të një plani të biznesit të mirëfillt. Për dallim prej viteve paraprake, bizneset tashmë duket që e kanë kuptuar rolin thelbësor që ka ky dokument.


Nga ana tjetër rreth 19 përqind e kompanive të anketuara në këtë studim, deklaruan që nuk bëjnë investime të mjaftueshme në trajnime për stafin e tyre. Kjo sipas tyre lidhet drejtpërdrejt me faktin që të hyrat e tyre nga shitja janë të limituara dhe që shpërndarja e fitimit me domosdoshmëri duhet të bëhet kryesisht në përmirësim dhe avancim të proceseve kyçe për ciklin e punës/prodhimit. Gjithashtu, ekziston frika tek ndërmarrjet se investimi në staf mund t'i bëjë ata (punëtorët) më tërheqës për ndërmarrjet e tjera kështu që ata do të largoheshin nga kompania dhe investimi do të kishte rezultat humbës.

Faktorët e brendshëm në industri



Shikur ndër vite, barrierat e faktorëve të brendshëm të industrisë kryesisht kanë qenë subjekt i përmirësimit të gjendjes. Sipas të gjeturave, viti 2015 paraqitet të ketë qenë viti më i rëndë për bizneset tona, sa i takon problemeve të brendshme të industrive. Viti 2017 tregon një trend në përmirësim.

Faktorët e brendshëm në industri sipas viteve






4.1 Faktorët e brendshëm sipas sektoreve

Mungesa e një plani të biznesit duket të jetë problem më i madh për sektorin prodhues në vend, pasuar nga sektori i tregtisë me pakicë. Poashtu, sektori i tregtisë me pakicë paraqet përqindjen më të lartë të problemit të profitabilitetit të ultë dhe investimeve të limituara në trajnimin dhe avancimin e stafit. Nga ana tjetër sektori i ndërtimit raporton probleme më të pakta të faktorëve të brendshëm.


Faktorët e brendshëm në industri sipas sektorëve



5. TENDENCAT E KOMPANIVE

Në figurën e mëposhtme janë paraqitur vlerësimet për nivelin e shitjeve të kompanive pjesëmarrëse në këtë hulumtim gjatë vitit 2017. Rreth 20 përqind e kompanive të anketuara treguan se shitjet e tyre nuk kanë kaluar vlerën € 10,000, ndërsa më shumë se gjysma e kompanive deklaruan se shitjet gjatë vitit 2017 sillen mes € 10,000 – € 500,000. Shitje mbi gjysmë milioni kishin një e katërta e kompanive të intervistuar. Bazuar në raportin e fundit “*Bottleneck*” të vitit 2016, përqindja e bizneseve që kishin deklaruar se kanë qarkullim nën € 10,000 ishte më e vogël krahasuar me këtë vit, kjo për shkak se tek disa kompani niveli i shitjeve kishte rënë nga vlera që sillet rreth € 50,000 – € 500,000 nën € 10,000 qarkullim në këtë vit. Prapa kësaj qëndrojnë faktor të ndryshëm, si mikro ashtu edhe makroekonomik, ndër ata që vlen të përmendet është rritja e nivelit të ekonomisë informale dhe konkurrencës jo – lojale, e cila ka ndikuar në ulje të aftësisë konkurruese tek këto biznese.


Vlerësimi i shitjeve për vitin 2017 (në Euro)



Pritjet e bizneseve kosovare për sa i përket nivelit të shitjeve në vitin e ardhshëm duket të jenë shumë optimiste. Rreth 80 përqind e bizneseve pjesëmarrëse në studim presin që qarkullimi i tyre të rritet, ndërsa rreth 18 përqind nuk presin ndonjë ndryshim në këtë drejtim. Vetëm 4 përqind e bizneseve parashikojnë se gjatë vitit 2018 shitjet e tyre do të zvogëlohen. Këto pritje pozitive të bizneseve tregojnë se aktiviteti biznesor i tyre do të rritet, e nga e gjithë kjo pritjet që të ketë një zhvillim të lehtë edhe në ekonominë e vendit.




Pritjet për shitje për vitin 2018




Lidhur me pritjet për shitje për vitin 2018, kompanitë e mëdha dhe ato të mesme kanë pritjet më të larta për nivelin e shitjeve, pasuar nga kompanitë e vogla. Asnjë kompani e madhe nuk pret që niveli i shitjeve të zvogëlohet. Në përgjithësi, një përqindje e vogël e kompanive të të gjitha madhësive presin që qarkullimi i tyre të zvogëlohet (prishmëria sillet mes 2 – 5%). Në Kosovë 98 përqind e kompanive janë mikro dhe të vogla, ndërsa 2% janë të mesme dhe të mëdha, mirëpo ndikimi i mikro ndërmarrjeve dhe atyre të vogla në ekonomi është më i madh. Bizneset e mesme dhe të mëdha zakonisht kanë më pak barriera. Kjo gjë është vërtetuar edhe në raportin “Klima e biznesit në Kosovë” të cilin Oda Ekonomike e Kosovës e publikon në baza të rregullta tremujore. Kompanitë e mëdha e kanë më të lehtë qasjen në financa, problemet e tyre me likuiditet janë më të vogla, andaj mund të rrisin shitjet me kredi / afat pagese dhe kështu të rrisin shitjet në total.

Pritjet për shitje për vitin 2018_sipas madhësisë së klasave (% e kompanive)



Të gjithë sektorët e anketuar të ekonomisë së Kosovës presin që shitjet e tyre të rriten gjatë vitit 2018, disa më pak e disa më shumë. Trendi mbetet dukshëm pozitiv, sidomos për sektorin e prodhimit, ndërtimit dhe shërbimeve, sektor këta kyç për zhvillim ekonomik dhe me pjesëmarrjen më të madhe në Bruto Produktin e Vendor. Oda Ekonomike e Kosovës në baza tremujore do të vëzhgojë vazhdimësinë e realizimit të këtyre pritjeve.


Pritjet për shitje për vitin 2018_sipas sektorëve






Kompanitë pjesëmarrëse në procesin e anketimit, janë pyetur edhe për faktin se a kanë fituar klient të rinj gjatë vitit 2017. Më shumë se 90% e kompanive kanë deklaruar se kanë fituar klient të rinj, kjo pasqyron punën e tyre në promovim, në një qasje më të mirë ndaj klientëve, marketing, rritje të cilësisë dhe krijimit të një brendi për produktet / shërbimet që ata ofrojnë. Bazuar në këto rezultate, nënkuptohet që puna e bizneseve është shtuar dhe si duket bizneset janë treguar të suksesshme në tërheqje të klientëve, e si pasojë edhe në rritje të kërkesës për produktet / shërbimet e tyre.

Klientët e rinj të fituar gjatë vitit 2017



Rreth 47% e kompanive të intervistuar të cilat janë përgjigjur me "Po" në këtë pyetje, kanë fituar klient të rinj në përqindje prej më pak se 10% nga totali i klientëve gjatë vitit 2017. Mbi 90% kishin thënë se kanë fituar klient të rinj, mirëpo përqindja e rritjes së klientëve nuk është shumë e madhe dhe sillet rreth 10 – 30%.

Nëse "Po" sa përqind?




Kompanitë e mëdha dhe të mesme janë ato që kanë fituar më shumë klient të rinj, pasuar nga kompanitë e vogla. Të gjithë kompanitë që i përkasin kategorisë së kompanive të mëdha kanë deklaruar të kenë fituar klient të rinj deri në 30%, më shumë në krahasim me vitin e kaluar. Situata e përgjithshme duket të jetë pozitive për të gjithë sektorët dhe kategoritë e klasave të kompanive.

Sa i përket sektorëve, rreth 26% e bizneseve të anketuara në sektorin e ndërtimit kanë raportuar se kanë fituar më shumë se 30% klient të rinj, pasuar nga sektori i shërbimeve. Ndërsa sektorët tjerë ndajnë të njëjtën përqindje (8%). Kompanitë që kanë fituar klient të rinj më pak se 10% përbëjnë një përqindje më madhe për sektorët e shitjes me shumicë dhe pakicë.




Klientët e rinj të fituar_sipas sektorëve




Më shumë se gjysma e kompanive të intervistuar kanë pohuar se investimet gjatë vitit 2017 në bizneset e tyre përkatëse janë rritur në krahasim me vitin paraprak. Kjo rritje e investimeve është një tregues i mirë dhe paraqet një zhvillim të mëtejshëm të bizneseve, drejt modernizimit të teknologjisë dhe mjeteve të punës. Investimet e bizneseve ishin më shumë të fokusuar në pasuri themelore. Tek 40% e kompanive ato kishin mbetur të njëjta, ndërsa vetëm 3% deklaruan se investimet e tyre kishin rënë, që përfaqëson një përqindje shumë simbolike. Të gjeturat për investime tregojnë se ky vit për bizneset kosovare ishte i suksesshëm sa i përket realizimit dhe rritjes së investimeve.

Zhvillimi i investimeve të bizneseve në vitin 2017 në krahasim me vitin 2016




Kompanitë e mëdha dhe të mesme përsëri kryesojnë sa i përket zhvillimit të investimeve në kompani në vitin 2017 në krahasim me vitin 2016, pasuar nga bizneset e vogla. Të gjitha kompanitë e mëdha të intervistuar kanë deklaruar se kanë rritur investimet në kompani, edhe pse periudha e kthimit të investimit mund të jetë më e gjatë tek kompanitë e mëdha në krahasim me ato mikro dhe të vogla, kjo për shkak të vlerës së madhe investuese. Prandaj, realizimi i këtyre investimeve kërkon një monitorim të kujdesshëm meqenëse efektet e të cilave vërehen në periudha të mëvonshme. Prandaj, rritja e investimeve nga kompanitë e mëdha pritet të ketë një rol më substancial në rritje ekonomike në të ardhmen e afërt.

Zhvillimi i investimeve të bizneseve në vitin 2017 në krahasim me vitin 2016? Sipas madhësisë së biznesit




Në aspektin sektorial, investimet janë rritur kryesisht në sektorin e ndërtimit, prodhimit dhe të shërbimeve. Investimet në tregtinë me pakicë dhe shumicë ishin kryesisht investime në inventar të mallit dhe zgjerim të pikave shitëse, ndërsa rritja e investimeve në sektorin e prodhimit dhe shërbimeve ishte kryesisht në zgjerim të linjave prodhuese / shërbyese dhe zgjerim të gamës së produkteve / shërbimeve.

Zhvillimi i investimeve të bizneseve në vitin 2017 në krahasim me vitin
2016_sipas sektorëve

5.1 Pritjet e bizneseve për zhvillimin e investimeve në vitin 2018

Një pjesë e raportit përfshinë edhe planifikimet e kompanive kosovare rreth zhvillimit të investimeve në të ardhmen. Kur janë pyetur kompanitë për pritjet që kanë për investime, krahasuar me vitin 2017, rreth 99% e kompanive të cilat ishin të përfshira në procesin anketimit kanë deklaruar se parashikojnë të rrisin ose të mbajnë të njëjta investimet në vitin 2018. Vetëm 1% e kompanive presin të zvogëlojnë investimet.


Pritjet mbi zhvillimin e investimeve të bizneseve në vitin 2018 në krahasim me vitin 2017



Investimet në vitin 2018 pritet të rriten në sektorin e ndërtimit, në atë prodhues dhe në sektorin e tregtisë me shumicë. Një përqindje shumë simbolike e kompanive presin që investimet të zvogëlohen, e që sillet rreth 1 – 3 %. Në sektorin e ndërtimit asnjë kompani nuk pret që investimet të zvogëlohen në vitin 2018. Këto rezultate paraqesin hapat e suksesshëm të ndërmarrë të bizneseve kosovare drejt maturimit dhe strukturimit të bizneseve të tyre.




Pritjet mbi zhvillimin e investimeve të bizneseve në vitin 2018 në krahasim me vitin 2017_sipas sektorëve




Kompanitë mikro dhe të vogla janë ato që kanë pritjet më të ulëta për investime në krahasim me të tjerat. Ndërsa asnjë prej kompanive të mesme dhe të mëdha nuk parashikojnë që investimet në vitin 2018 të bien. Pra, pritet që situata në vitin 2018 sa i përket investimeve të jetë më e mirë se në vitin paraprak.

Pritjet mbi zhvillimin e investimeve të bizneseve në vitin 2018 në krahasim me vitin 2017_sipas madhësisë së bizneseve



Në anketën e *"Fytave të Ngushta"*, kompanitë janë pyetur edhe për llojin e investimeve që planifikojnë të bëjnë gjatë vitit 2018. Kompanitë kosovare të të gjithë sektorëve kryesisht kanë planifikuar të zëvendësojnë mjetet / makineritë e vjetra dhe të modernizojnë asetet ekzistuese (44%). Rreth 43% e kompanive të anketuara planifikojnë të zgjerojnë linjat e prodhimit / shërbimeve ekzistuese, pra të rrisin kapacitetet e tyre ekzistuese dhe të krijojnë kapacitete në fusha të reja të prodhimit / shërbimeve. Nga ky studim kuptohet se vetëm një përqindje e vogël (6%), brengosen për ndotjen e ajrit apo sigurinë në vendin e punës.


Investimet e planifikuara për vitin 2018?



Për qëllime të këtij studimi, kompanitë janë pyetur rreth mjeteve të menaxhimit të cilat ato i aplikojnë. Ndër mjetet e menaxhimit më të përdorura janë raportet financiare, respektivisht 73% e kompanive të anketuara kanë theksuar që përdorin këtë mjet. Raportet financiare nga ana e kompanive janë përdorur kryesisht për qëllime tatimore, ndërsa tek një përqindje më e vogël për qëllime të brendshme dhe të informimit të investitorëve potencial për gjendjen dhe performancën financiare të tyre. Mbi 40% e kompanive kanë deklaruar se kanë një plan biznesi në bazë të të cilit përcaktojnë operacionet e tyre. Vetëm 19% e kompanive theksuan se aplikojnë ISO standard 9001:2015, e këto kompani kryesisht i takonin sektorit të



prodhimit. Certifikimi i kompanive me ISO standard duket që luan një rol të rëndësishëm në rritje të eksportit dhe rritje të besueshmërisë ndaj produkteve kosovare. Vendet e Bashkimit Evropian kërkojnë që produktet të jenë cilësore dhe të ketë një dokument që e vërteton këtë cilësi. Rrjedhimisht bizneseve u duhet një mbështetje më të madhe nga shteti për standardizim, certifikim dhe licencim, me qëllim rritjen e aftësive konkurruese dhe promovimin e potencialeve të Kosovës në tregti. OEK mund të jetë faktor i rëndësishëm në nxitjen e përdorimit të standardeve.




5.2 Fuqia punëtore

Një seksion i këtij studimi është ndarë edhe për fuqinë punëtore si një burim themelor për operimin të suksesshëm të biznesit. Kjo pjesë është trajtuar me qëllim të evidentimit të situatës aktuale biznesore në gjetjen e fuqisë punëtore sipas nevojave të kompanive. Një analizë e detajuar është bërë për të identifikuar dhe për të pasqyruar në këtë raport vështirësitë e kompanive për të gjetur punëtorë të shkathtë dhe mundësitë e krijimit të vendeve të reja të punës në aspektin sektorial, rajonal dhe madhësisë së bizneseve.


Bizneset janë pyetur se a kanë pasur vështirësi për të gjetur punëtorë të kualifikuar dhe me shkathtësi adekuate për punë në bazë të profilit të biznesit të tyre. Bazuar në evidencën e marrë nga bizneset pjesëmarrëse në hulumtim, rreth 76% kanë hasur në vështirësi për të gjetur punëtorë të kualifikuar dhe profesional, ndërsa vetëm 24% treguan se nuk kishin vështirësi të kësaj natyre. Këto rezultate tregojnë se kompanitë kosovare akoma janë duke u ballafaquar me mungesë të punëtorëve të shkathtë dhe të kualifikuar sipas profilit të kompanisë. Përderisa qasja në arsim nuk është një shqetësim i madh, mirëpo cilësia e arsimit në përgjithësi në Kosovë konsiderohet e ulët, një problem që po trashëgohet nga viti në vit. Në indeksin e fundit të UNDP – së për zhvillim njerëzor (Human Development Index), Kosova është ranguar në vendin e 87 – të në botë, prapa të gjitha vendeve të rajonit dhe ka përformuar tejet dobët në PISA 2016, ku ishim 3 vende nga fundi; vetëm Republika Dominikane dhe Algjeria shënuan poentim më të ulët.

Për të arritur të njëjtin nivel me ekonomitë e zhvilluara, ekonomitë në zhvillim zakonisht duhet të miratojnë përparime teknologjike. Ligji i stimulimit në rastet e ngecjeve prapa shpjegon se hapat e mëdhenj mund të bëhen gjatë transformimit të ekonomisë. Megjithatë, që të jenë në gjendje të adaptojnë inovacionet e reja, bizneset kanë nevojë që të kenë qasje në një fuqi punëtore me aftësi që të krijojnë, përvetësojnë dhe të përdorin teknologjitë e reja për rritjen e produktivitetit. Mungesa e njerëzve me shkathtësi për të përfituar nga teknologjitë e reja mund të pengojnë potencialisht investimet private dhe rritjen ekonomike.

Vështirësitë për të gjetur punëtorë të kualifikuar bazuar në profilin e
biznesit gjatë vitit 2017

Analizuar në perspektivë sektoriale, vështirësi më të madhe për të gjetur punëtorë të kualifikuar dhe të shkathtë kishte hasur sektori i ndërtimit, ku rreth 86% e kompanive e kishin cilësuar si të vështirë gjetjen e punëtorëve të kualifikuar në bazë të profilin e tyre. Me të njëjtin problem janë përballur edhe kompanitë që veprojnë në sektorin e prodhimit dhe shërbimeve. Punëtorët që punojnë në këta sektorë duhet të kenë aftësi të larta dhe të jenë shumë produktiv, por për fat të keq kompanitë kanë hasur në shumë vështirësi gjatë kompletimit të stafit të tyre. Përderisa bizneset operojnë në një mjedis kompleks, veprimtaria e tyre ndikohet nga shumë faktorë të jashtëm dhe të brendshëm, mirëpo kapitali njerëzor me shkathtësi për punë është një faktorë relevant që ndikon në suksesin e biznesit, e më të cilin bizneset kosovare janë duke pasur probleme.

Vështirësitë për të gjetur punëtorë të kualifikuar bazuar në profilin e biznesit gjatë vitit 2017_ sipas sektorëve (% e kompanive)




Duke u bazuar në madhësinë e bizneseve, bizneset e mëdha kanë deklaruar se kanë pasur më shumë vështirësi për të gjetur punëtorë të kualifikuar, pasuar nga kompanitë e vogla. Ndërsa mikro kompanitë dhe ato të mesme janë ballafaquar më pak me këtë barrierë. Asnjëra nga kompanitë e mëdha pjesëmarrëse në studim nuk ka thënë se ishte e lehtë të gjenin punëtorë të kualifikuar. Kjo situatë bizneseve vetëm u ka shtuar vonesa dhe shpenzime shtesë në procesin e rekrutimit të stafit.

Mungesa e kapitalit njerëzor të kualifikuar paraqitet po ashtu si barrierë për investime, situatë kjo që do të shkaktonte një konkurrencë në mes të kompanive për të punësuar atë numër të pakët të punëtorëve të shkathtë. Kjo do të reflektohej në uljen e normës së papunësisë për punëtorët e shkathët dhe në rritje të pagave për këtë kategori të punëtorëve. Pritet që kjo situatë të stimulojë dhe vetëdijësojë të diplomuarit që të aftësohen për tregun e punës.




Vështirësitë për të gjetur punëtorë të kualifikuar bazuar në profilin e biznesit gjatë vitit 2017_ sipas madhësisë së biznesit (% e kompanive)




Rezultatet e paraqitura në figurën e mëposhtme tregojnë se rajoni i Mitrovicës, pasuar nga ai i Ferizajit dhe Prizrenit janë rajonet që e kanë pasur më të vështirë të gjenin punëtorë të kualifikuar. Ndërsa rajonet që e kishin më të lehtë të përzgjedhin stafin në bazë të nevojave të tyre ishte rajoni i Gjakovës, Pejës dhe Prishtinës.

Vështirësitë për të gjetur punëtorë të kualifikuar bazuar në profilin e biznesit gjatë vitit 2017_ sipas rajoneve (% e kompanive)



Bizneset e anketuara janë pyetur edhe për trendin e punësimit që ato kishin në tre vitet e fundit. Më shumë se gjysma e tyre kanë deklaruar se trendi është në rritje, kishte mbetur i njëjtë te 43% e të anketuarve dhe vetëm 4% potencuan se kishin një trend në rënie gjatë 3 viteve të fundit. Shikuar në një perspektivë të përgjithshme, duke u bazuar në këto të gjetura konsiderohet që sektori privat në tre vitet e fundit duket se ka kontribuar mjaft shumë në gjenerim të vendeve të reja të punës. Në raportin e fundit të Bankës Botërore (prill 2018) thuhet se shkalla e pjesëmarrjes në tregun e punës u rrit me 3.3 përqind dhe punësimi me 1.3 përqind. Kjo gjithashtu konfirmon trendin e gjetjeve në studimin e fyteve të ngushta/bottleneck.


Trendi i punësimit në kompani, në tre vitet e fundit?



Afër 70% e kompanive pjesëmarrëse kanë deklaruar se do të rrisin numrin e punëtoreve në vitin 2018. Rritja më e madhe pritet të bëhet gjatë sezonit të verës, kur në këtë kohë ka një fluks më të madhe të vizitorëve, kryesisht diaspora jonë, kjo reflektohet mëpastaj edhe me një rritje të aktivitetit të bizneseve gjatë kësaj kohe. (Kjo reflektohet edhe në serinë kohore të konfidencës së biznesit, studimit tremujor të klimës së biznesit të bërë nga OEK.) Ndërsa, rreth 31% e të anketuarve nuk kanë planifikuar të rrisin stafin e tyre.




Pritjet për punësim në vitin 2018




Pritjet më të mëdha për punësim për vitin 2018 i ka rajoni i Ferizajit së bashku me atë të Mitrovicës, respektivisht 83% e kompanive që veprojnë në këto dy rajone kanë planifikuar që të rrisin numrin e punëtorëve të tyre. Në anën tjetër, pritjet më të ulëta i ka rajoni i Gjakovës dhe i Gjilanit. Në përgjithësi, bizneset janë shumë optimiste sa i përket rritjes së stafit të tyre.

Pritjet për punësim në vitin 2018_sipas rajoneve (% e kompanive)




Në bazë të rezultateve të nxjerra nga analiza sektoriale, sektori i prodhimit ka pritjet më të larta për punësim, rreth 82% e bizneseve kanë potencuar se do të ketë një rritje të punëtoreve. Pritje pozitive kanë edhe sektori i tregtisë me shumicë, ndërtimit dhe shërbimeve. Me pritjet më të ulëta është gjetur të jetë sektori i tregtisë me pakicë.



Kompanitë që kanë planifikuar të rrisin numrin e punëtorëve, kanë përcaktuar se sa punëtorë presin të punësojnë. Më shumë se gjysma kanë theksuar se do të punësonin 1 – 3 punëtorë gjatë vitit operativ. Ndërsa, vetëm 11% e bizneseve pjesëmarrëse në studim presin të punësojnë më shumë se 10 punëtorë.




Nëse po, sa punëtorë?



Kryesisht kompanitë e mëdha dhe të mesme presin të punësojnë më shumë se 10 punëtorë, ndërsa mikro ndërmarrjet presin të punësojnë 1 – 3 punëtorë.


Në kuadër të anketës bizneset janë pyetur se sa janë të gatshëm të bashkëpunojnë me institucione ose donatorë për subvencionim të pagës së punëtorëve të rinj, nëse këtë barrë do ta merrnin përsipër institucionet / donatorët përkatës. Mbi 70% e bizneseve kanë deklaruar se do të ishin të kënaqur të bënin një bashkëpunim të tillë. Rreth 6% deklaruan se nuk kishin përvojë në këtë fushë dhe nuk kishin shumë njohuri rreth kësaj mundësie.

Gatishmëria e bizneseve për bashkëpunim me institucione / donatorë në fushën e subvencionimit të pagave për punonjës të rinj



Rreth 91% e bizneseve të cilat kishin thënë që ishin të gatshëm të bashkëpunonin në fushën e subvencionimit të pagës së punëtorëve të rinj, ishin të gatshëm të mbanin në punë ata punëtorë pas periudhës së subvencionimit, nëse ata do të tregoheshin të suksesshëm në kryerjen e punëve gjatë kësaj periudhe. Vetëm 9% kanë deklaruar se nuk janë në gjendje të mbajnë në punë këta punëtorë.


Nëse po, a do t'i mbani ata në punë pas përfundimit të periudhës së subvencionimit nëse ata janë të suksesshëm?



Afër 70% e bizneseve të intervistuar kanë deklaruar se janë të gatshëm të pranojnë praktikant gjatë vitit 2018, me qëllim të krijimit të një mundësie për profesionalizim dhe kryerjes së një përvojë praktike në bazë të profilit të tyre. Kjo do të jetë një përvojë e mirë për studentët e diplomuar në mënyrë që të përballen me kërkesat e tregut të punës, dhe të kombinojnë pjesën teorike me atë praktike, duke ndikuar kështu në përgatitjen dhe avancimin e tyre profesional konform kërkesave të bizneseve. OEK vazhdon të jetë faktor kyq në organizimin e këtyre mundësive. Është vazhdimësi e projekteve të mëhershme që OEK-u ka implementuar. OEK-u jep rëndësi të madhe përmirësimit të gjendjes së tregut të punës pas analizave të shumta dhe asaj të avancuar të ashtuquajtur "fishbone" që bëri në vitin 2016, përmes së cilës përcaktohen shkaqet e një gjendje të tillë, por dhe hapat e nevojshëm për veprim të mëtutjeshëm.




Gatishmëria e bizneseve për të pranuar praktikant për vitin 2018



6. BARRIERAT E PËRGJITHSHME DHE SFIDAT

Oda Ekonomike e Kosovës duke pasur për qëllim identifikimin dhe evidentimin e problemeve me të cilat kompanitë ballafaqohen e që ishin shumë të përfolura gjatë vitit 2017, kryesisht për mos liberalizimin e vizave, skemat e granteve, Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA) dhe fenomenin e dhënies së ryshfetit, ka vendosur të sjellë raportin e “Fytave të Ngushta” me përgjigje/inpute nga kompanitë kosovare. Mos liberalizimi i vizave për Kosovën ka ndikuar në humbje të klientëve ndërkombëtar dhe në prishje të marrëveshjeve tek 44% e kompanive pjesëmarrëse në studim dhe kishte ndikuar në rënie të eksportit tek 38% e të anketuarve. Rreth 39% e kompanive kanë raportuar se ka ndikuar në zvogëlim të aftësive të tyre konkurruese. Mos liberalizimi i vizave edhe këtë vit duket se ju ka shkaktuar shumë probleme bizneseve kosovare, e më të cilat duket se do të ballafaqohen edhe në të ardhmen e afërt.


Mos liberalizimi i vizave për Kosovën, ka ndikuar:






Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA), ka hyrë në fuqi në Prill të vitit 2016, dhe që nga atëherë ka filluar të ketë efektet e saj. Bazuar në evidencën e marrë nga kompanitë, MSA-ja rol më signifikant ka luajtur në gjetjen e partnerëve të ri biznesor (33%), në stimulim dhe rritje të eksportit. Ndikim pozitiv kjo marrëveshje pati tek 21% e kompanive eksportuese kosovare në zgjerimin e kompanive të tyre me degë të reja në vendet e BE-së. Duke konsideruar potencialin e kompanive kosovare për eksport në BE, kjo përqindje e bizneseve paraqet një sinjal të dukshëm pozitiv për rritje të eksporteve të Kosovës në dekadën e ardhshme. Përveç kësaj kjo marrëveshje ka kontribuar në një qasje më të lehtë në teknologji, ekspertizë dhe zgjerim të mundësive të tregtisë dhe investimeve. Po ashtu, stimulon krijimin e një konkurrence të re nga vendet e BE – së, lind nevojën për inovacione dhe shtim të produktivitetit nga ana e kompanive në mënyrë që të jenë në hap me kompanitë evropiane.

Efektet e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) me Bashkimin Evropian në biznese




Gjithashtu, në këtë studim do të prezantojmë perspektivën e bizneseve lidhur me grantët që u janë ndarë bizneseve. Vetëm 6% e bizneseve kanë raportuar se janë subvencionuar nga shteti. Është e lehtë të arrijmë në përfundime apo konkluzione për opinionet e tyre rreth transparencës së dhënies së këtyre granteve. Një përqindje e konsiderueshme e bizneseve potencuan se procesi i subvencionimit nuk ishte transparent. Kompanitë që operojnë në sektorin e prodhimit janë subvencionuar më shumë nga shteti krahasuar me sektorët e tjerë.

Subvencionimi nga shteti



Kompanitë e rajonit të Ferizajit ishin ato që kishin përfituar më shumë nga skema e granteve, pasuar nga rajoni i Prizrenit. Shikuar në përgjithësi numri i kompanive që kanë fituar grante të cilat duhet të ishin mbështetëse dhe të orientuara në zhvillim të biznesit është shumë i vogël. Kompanitë kanë theksuar nevojën e madhe që kanë për mbështetje financiare nga shteti.

Subvencionimi nga shteti_ sipas regjioneve (% e kompanive)






Bizneset janë pyetur edhe për faktin, nëse qeveria / shteti e subvencionon sektorin / aktivitetin e tyre, cilat do të ishin tre segmentet ku do të kishin investuar fillimisht me atë subvencion. Pavarësisht shumëllojshmërisë së përgjigjeve të bizneseve kemi listuar tre segmentet ku do të investonin bizneset fillimisht. Investimet në pasuri themelore dhe stogë / inventar të mallit janë vlerësuar si segment ku bizneset kanë nevojë më së shumti të investojnë, pasuar nga investimet në zhvillim profesional të stafit, kryesisht në formë të trajnimeve dhe rritjes së numrit të punëtorëve dhe zgjerim të biznesit (rritje të prodhimit, kapaciteteve prodhuese / shërbyese, pika të reja të shitjes).


Bazuar në të gjeturat e këtij studimi, shikuar në një perspektivë të përgjithshme, kompanive kosovare u mungon mbështetja për licencim, standardizim dhe vlerësim të konformitetit. Vetëm 33% e kompanive të anketuara vlerësuan se bizneset kanë mbështetje të mjaftueshme, ndërsa pjesa tjetër e vlerësuan se kjo mbështetje nuk mjafton dhe se duhet të bëhet më shumë nga ana e organeve kompetente.

Mbështetja e bizneseve kosovare për licencim, standardizim dhe vlerësime të konformitetit




Një pjesë e pyetësorit të "Fytave të Ngushtë" ka përfshirë edhe aspektin e mitos apo ryshfetin që japin kompanitë gjatë operimit të tyre. Edhe pse shumica e kompanive hezituan të përgjigjen në këto pyetje, megjithatë, grupi anketues insistoi që të merr një opinion prej tyre. Më shumë se 90% e kompanive pjesëmarrëse në hulumtim deklaruan se nuk kanë dhënë mito gjatë vitit 2017. Rreth 7% theksuan se kishin dhënë ryshfet dhe 2% thanë se e kishin aplikuar si formë ryshfetin, në njëfarë mënyre.

Dhënia e mitove / ryshfetit gjatë operimit të biznesit



Rreth 50% e kompanive që deklaruan të kenë dhënë ryshfet , thanë që atë e kanë bërë vetëm një herë gjatë vitit. Vetëm 6% e kompanive të anketuara kishin dhënë mito më shumë se katër herë.

Nëse po, sa herë gjatë vitit 2017?




Rreth 41% e bizneseve të intervistuar mendonin se legjislacioni ekonomik për stimulim të eksportit nuk ishte favorizues dhe se ky legjislacion duhet të përmirësohet në mënyrë që të ketë një efekt më pozitiv të bizneset dhe të ndikojë në rritje të eksportit. E kjo gjë mund të bëhet përmes aplikimit të lehtësirave doganore, lehtësirave tatimore, skema të veçanta të financimit të eksportit dhe subvencionimit të kompanive që eksportojnë. Po ashtu është e nevojshme që të bëhet unifikimi i rregullave dhe procedurave të tregtisë dhe plotësimi i




kritereve teknike në mënyrë që të arrihet edhe promovimi i eksportit. 15 përqind e kompanive ishinte mendimit se legjislacioni ekonomik është favorizues dhe po ndikon në stimulim të eksportit.

Legjislacioni ekonomik i Kosovës favorizues për stimulim të eksportit



Prioritetet kryesore të kompanive për vitin 2018 janë kryesisht të fokusuar në rritje të tregut, mbajtje të tregut aktual dhe zgjerim të gamës së produkteve / shërbimeve. Këto perspektiva të tyre janë shumë premtuese dhe nëse bizneset arrijnë t'i plotësojnë e gjithë kjo do të pasqyrohet në një rritje dhe zhvillim të mëtejshëm të tyre.

Prioritetet kryesore të kompanive për vitin 2018



7. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

1. *Ekonomia informale/* Konkurrenca jolojale e shkaktuar nga ekonomia e hirtë është pengesa kryesore për të bërë biznes në Kosovë për vitin 2017 për të gjithë sektorët e ekonomisë së vendit. Ekonomia joformale paraqet sfidën kryesore për sektorin privat (formal) në Kosovë. Në vitet e fundit, qeveria i ka kushtuar vëmendje zhvendosjes së ndërmarrjeve të hirta në ekonominë formale. Si rezultat, shumë ndërmarrje tani funksionojnë ligjërisht. Megjithatë, ende ekzistojnë një numër i konsiderueshëm i ndërmarrjeve jo (ende) të formalizuara, dhe "ndërmarrjet e reja" (enfant enterprises) e ndjejnë konkurrencën e pandershme. Gjithashtu, "ndërmarrjet e reja" përballen papritmas, nga këndvështrimi i tyre, me rregulla dhe procedura të reja, duke përfshirë taksat dhe raportet. Shqetësimet e sektorit privat vendor po rriten, dhe kjo është më e theksuar nga informaliteti në rritje në veri të vendit, sidomos kur është fjala për produktet me rëndësi strategjike. OEK ngreh shqetësime në lidhje me mosfunksionimin e mekanizmave shtetërorë për të mbajtur kontrollin e informalitetit që ka dëmtuar në masë të madhe aftësinë konkurruese dhe zhvillimin e potencialeve të ndërmarrjeve dhe njëkohësisht kërkon lehtësimin e procedurave dhe rregullave dhe t'i bëjë ato më pak të komplikuar;
2. *Forcimi i sundimit të rendit dhe ligjit/* Kosova si shtet i ri përballlet me sfida të mëdha, veçanërisht në zbatimin e rendit dhe ligjit. Kur komuniteti i biznesit kosovar doli nga lufta hyri në një mjedis biznesor të "paarmatosur" dhe ende jo të rregulluar. OEK ka theksuar në mënyrë të përsëritur nevojën për të përmirësuar mjedisin ligjor si parakusht për funksionimin dhe zhvillimin e biznesit. Vonesat e proceseve gjyqësore prej vitesh kanë bërë që bizneset të humbin besimin në gjykata, madje edhe herë pas here të mos i mendojnë gjykatat si një opsion për zgjidhjen e problemit. Poashtu, kur vendimi kthehet pozitivisht, vonesat e vendimeve për bizneset shpesh kanë rezultuar në falimentim. Zbatimi i ligjit mbetet një çështje e rëndësishme. Oda Ekonomike e Kosovës, në përputhje me nevojat e biznesit brenda gamës së shërbimeve të saj, ka tribunalin e arbitrazhit, i cili në masë të madhe lehtëson zgjidhjen e problemeve të biznesit në mosmarrëveshjet biznesore vendore dhe ndërkombëtare. OEK beson se kriza ligjore ka më shumë ndikim mbi ndërmarrjet sesa kriza ekonomike. Nevojitet një riorganizim i plotë për të reformuar legjislacionin aktual sipas rrethanave në

Kosovë. Kjo dëshmohej përmes disa treguesve ekzistues (p.sh. konfidenca e biznesit dhe studimet e fyteve të ngushtuara të publikuara nga OEK-u);

3. *Mbështetje për aftësim profesional dhe edukim gjatë gjithë jetës/Qeveria dhe Parlamenti i Republikës së Kosovës duhet të nxjerrin dhe miratojnë një paketë ligjore që mundëson zbatimin e sistemit të "Arsimit të Dual" dhe "Trajnimeve Profesionale", i frymëzuar nga përvojat, për shembull, vendet gjermano-folëse, por domosdoshmërisht të përshtatura me specifikat vendore. Hulumtimi i OEK-ut tregon qartë se një nga barrierat kryesore është mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar me shkathtësi të veçanta. Si rezultat i mungesës së fuqisë punëtore të shkathtë, kompanitë nuk shfrytëzojnë potencialin e tyre dhe kapacitetet prodhuese që kanë qoftë për tregun e brendshëm, qoftë për eksport. Kurrikulat ekzistuese në Kosovë nuk janë në përputhje me nevojat aktuale të tregut të punës, e aq më pak me tendencat globale të parashikuara për 30 vitet e ardhshme. Zbatimi i sistemit të "Arsimit Dual" kërkon, përveç kurrikulës së re, standarde të reja profesionale dhe një buxhet të veçantë. Prandaj, OEK rekomandon që në buxhetin që do të parashikohet për vitet e ardhshme, financimi i zbatimit të "Arsimit Dual" të jetë një nga prioritetet kryesore. Përshtatja e programeve arsimore me nevojat e komunitetit të biznesit me siguri do të rrisë produktivitetin dhe potencialin e tyre, veçanërisht duke rritur aftësinë konkurruese dhe penetrimin në tregjet e huaja. Një hap tjetër do të ishte përfshirja e përfaqësuesve të sektorit privat në bordet e shkollave. Ky është një mekanizëm i lirë që bën të mundur që shkollat të informohen nga komunitetet e biznesit për tema relevante për zhvillim të mëtejshëm;*
4. *Klasifikimi i kostos së energjisë elektrike/ për industrinë ndryshon nga ai në amvisëri. Industria konsideron që kostot janë shumë të larta dhe bizneset nuk janë të kënaqur në raport me shpërndarjen e energjisë, e cila shpesh ndërpritet dhe nuk ka furnizim të rregullt. Rekomandohet shfrytëzimi i burimeve natyrore që Kosova posedon (rezervat e linjitit). Ndërtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese (termocentrali Kosova e Re) duhet të nisë sa më shpejtë. Përveç kësaj, transformimi i politikës globale të energjisë nënkupton një rritje të investimeve publike dhe private në efikasitet. Përdorimi i burimeve të ripërtritshme dhe plotësuese/komplementare me vendet e rajonit, në kuadër të një tregu rajonal të energjisë, gjithashtu kërkon nisma të reja. Në të gjitha këto rrethana, kur ka shumë paqartësi për të ardhmen e sektorit të energjisë në Kosovë, sektori privat vazhdimisht paguan shpenzime të papërbalueshme që*

lidhen me mungesën e furnizimit të rregullt dhe të qëndrueshëm me energji elektrike. Kjo vazhdon për 18 vite me rradhë. Bazuar në vlerësimet e studimeve të ndryshme, shpenzimet shtesë në baza vjetore arrijnë vlerën prej 300 milion euro. Elementet që kontribuojnë në këtë janë investimet në rrjete të ndryshme, naftë, stabilizues të tensionit, dëmtime të pajisjeve, humbje direkte të produktivitetit etj. Eliminimi i pagesës "paushalle" si pengesë kryesisht manifestohet nga pakënaqësia me pagesën e shpenzimeve të energjisë elektrike për veriun e Kosovës, nga institucionet kosovare. (Kjo krijon gjithashtu konkurrencë të padrejtë.)

Kontrata e ndërtimit të termocentralit "Kosova e Re" u nënshkrua në dhjetor të vitit 2017 dhe pritet të fillojë ndërtimin në fillim të vitit 2019. Sidoqoftë, që nga fillimi, ekzistonte frika që shkalla e brendshme e kërkuar e kthimit (IRR) do të çonte në një rritje të konsiderueshme të çmimeve.

Në vazhdim të këtij dimension, propozohen veprimet e mëposhtme:

- Rritja e fondit për efikasitet të energjisë, me mundësi përfitimi për të gjitha bizneset (MZHE);
 - Përfundimi i tregut të përbashkët të energjisë mes Kosovës dhe Shqipërisë, financiar nga KfW (KOSTT dhe qeveria);
 - Rritja e fondit për përkrahje të instalimeve të paneleve solare dhe pajisjeve tjera që mundësojnë gjenerim të energjisë nga burime të ripërtitshme, në bizneset prodhuese (Minsitritë e ndryshme)
 - Subvencionimi i një pjesë të faturave të energjisë elektrike për prodhimet që eksportohen (Ministritë e ndryshme);
 - Përkrahje financiare për start-up dhe biznese të vogla për kyçe në rrjet (MZHE, MIN dhe MTI);
 - Ndryshimi i modelit tarifor duke kufizuar ndër-subvencionimin në mes kategorive të ndryshme të konsumatorëve, dhe rritja e konkurrencës në furnizim (ZRRE);
 - Trajtimi i "ngarkesës në kapacitet" (maksigrafit), në bazë të praktikave rajonale dhe të vendeve të BE-së (ZRRE);
5. *Kosto e lartë për të dëshmuar standardet ndërkombëtare/ në ditët e sotme, disa biznese e kuptojnë rëndësinë e standardeve të njohura (si HACCP ose HALAL). Sidoqoftë, kjo është e rastësishme dhe në përgjithësi standardet ndërkombëtare konsiderohen si një pengesë e rëndësishme për ndërmarrjet e Kosovës. Para së gjithave është një çështje e njohjes së rëndësisë dhe ndjekja e disiplinës që vjen me procedurat e kërkuara. Shumë ndërmarrje thjesht dështojnë të shohin rëndësinë dhe mendojnë se standardet janë shumë të kushtueshme. Nuk ka shumë njohuri*

ekzistuese nga ndërmarrjet rreth kësaj fushe; dhe OEK në këtë drejtim mund të zhvillojë kurse dhe sesione informimi mbi këtë temë. Përveç çështjeve të të kuptuarit dhe disponueshmërisë së trajnimeve është edhe problemi që në Kosovë nuk ka institucione certifikuese dhe ekspertët duhet të vijnë nga jashtë, për shembull nga Greqia. E gjithë kjo do të thotë se kostoja do të rritet dhe kjo përsëri do të ulë interesin e ndërmarrjeve. Qeveria mund të fillojë një projekt gjithëpërfshirës që do t'u mundësojë ndërmarrjeve të kuptojnë rëndësinë e standardeve, t'i trajnojnë ata mbi këtë temë dhe ta bëjnë më të lehtë marrjen e certifikatave të kërkuara. OEK rekomandon transparencë dhe përfshirje në programet mbështetëse për prodhuesit, veçanërisht në certifikimin, standardizimin dhe vlerësimin e konformitetit;

6. *Mbështetje e bizneseve në digjitalizim dhe rrjetizim*, bazuar në agjendën e Procesit të Berlinit i dedikuar për WB6 (vendet e Ballkanit Perendimor) një ndër objektivat e këtij procesi është edhe digjitalizimi dhe rrjetizimi i ndërmarrjeve dhe bizneseve në rend të parë në vendet anëtare të WB6 dhe në rend të dytë rrjetizimi ndërshtetëror. Në këtë drejtim OEK rekomandon institucionet shtetërore për mbështetje të sektorit privat në Kosovë në këtë dimension si parakusht i ndërkombëtarizimit të plotë të ndërmarrësisë vendore;
7. *Hartimi i planeve të biznesit dhe zbatimi i tyre, është përmendur si pengesë*. Mbështetja në hartimin e planeve të biznesit, studimet e fizibilitetit dhe strategjitë e ndryshme mund të ndihmojnë ndërmarrjet. Bizneset, në përqindje të konsiderueshme, theksuan problemin e mungesës së planeve të biznesit, si kusht kryesor për financim nga bankat, por edhe nga donatorë të tjerë. OEK ka krijuar një platformë online për krijimin e planeve të biznesit <http://oek-biznesplan.org/> i cili po gjenë aplikim të mirë. Kërkesë e biznesit mbetet mundësia e mbështetjes financiare në këtë drejtim. Rekomandohet, mbështetje alternative (financuese) për planet e biznesit të sektorit privat në Kosovë. Mbështetja për këtë pikë do të rezultojë me mbështetjen e sektorit privat në promovimin e shërbimeve, produkteve dhe mundësive në tregjet lokale, rajonale dhe ndërkombëtare. Megjithatë, një plan biznesi nuk është vetëm një mjet për çasjenë financa, por edhe një udhëzues për menaxhim;
8. *Avancimi i partneriteteve me bankat komerciale në Kosovë* nën monitorimin e BQK-së për të lejuar norma fleksibile të interesit në interes të sektorit privat dhe në veçanti sektorit prodhues. Këto partneritete do të përmirësojnë treguesit e rëndësishëm ekonomikë për ekonominë e Kosovës, të dukshme në aspekte të tilla si punësimi,

integrimi, multietniciteti. Përveç kësaj, do të përmirësojë bilancin e pagesave dhe do të promovojë imazhin e Kosovës përmes brendimit të produkteve dhe shërbimeve tona. Instrumente të tjera mund të zhvillohen edhe nga bankat, siç janë procedurat lehtësuese. Qeveria gjithashtu mund të zhvillojë mekanizma të posaçëm mbështetës (p.sh. për industrinë e vogla dhe / ose fillestare), siç janë pushimet tatimore;

9. *OEK rekomandon krijimin e një të ashtuquajtur "one-stop shop" për të eliminuar burokracinë institucionale, në veçanti në lidhje me licencat, lejet dhe certifikatat. Bizneset vendore dhe ato ndërkombëtare mund të marrin më shpejt dokumentet e kërkuara dhe të kryejnë detyrat e tyre me lehtësi duke eliminuar kështu burokracinë dhe dukuritë korruptive;*
10. *Koordinim i aktiviteteve me diplomacinë ekonomike në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme, për aderim, promovim dhe përmirësim të imazhit të Kosovës dhe produkteve "Made in Kosova";*
11. *Çasje në një rrafsh horizontal dhe jo vertikal në ndarjen e subvencioneve/ Kërkesa veçanërisht për sektorin prodhues, të cilët tregojnë një diskriminim dhe pabarazi në ndarjen e subvencionave nga qeveria, meqë rast në këtë drejtim, OEK kërkon transparencë dhe avancim të dialogut publiko-privat;*
12. *Definimi i rolit dhe përgjegjësisë konform kompetencave për ministritë e fushës ekonomike /Kosova ka krijuar një shembull jo të mirë të mos-koordinimit insitucional për politikat dhe veprimet për përkrahje të bizneseve, veçanërisht nxitje të eksportit dhe investimeve të huaja. Janë së paku 5 (pesë) ministri që kanë si synim rritjen e aftësisë konkurruese të sektorëve të caktuar dhe nxitjen e investimeve të huaja në vendin tonë. Përvojat me ndërmarrjet e huaja që kanë shprehur interes për investime në Kosovë, na tregojnë që në shumicën e rasteve "mesazhet" që përqohen të ta, mbi mundësitë e investimeve, nga dikasterët e ndryshëm të ekzekutivit, janë të ndryshme dhe me shumë kuptime. Një koordinim ndër-institucional dhe përqimi i një "mesazhi" të përbashkët insitucional, është një ndër parakushtet kryesore për fuqizim të promovimit të mundësive për investime dhe rritje të eksportit. Qeveria duhet të krijojë një mekanizëm të përbashkët në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, me buxhet dhe resurse humane adekuate, si dhe me fuqi negociuese, në mënyrë që politikat e promovimit të eksportive të jenë të koordinuara, të fuqishme dhe përmbytësore.*



ODA EKONOMIKE | KOSOVA CHAMBER
E KOSOVËS | OF COMMERCE

Rr. Nënë Tereza Nr.20
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel & Fax: +383 (0) 38 224 299
Mob. +383 (0) 45 677 877
info@oek-kcc.org, www.oek-kcc.org